

**1.1§ Autori:** *Miguel De Cervantes Savedra* (1547-1616). Ai lindi në Spanjë në 29 shtator 1547. Që në moshë të re ai shfaqti dy pasione, studimin dhe udhëtimin, të cilat ia rrënjosi i ati, i cili ishte një mjek shëtitës. Në vitin 1569 botohen katër poezi të tij të para. Jeta e tij ndryshon drejt kur në 1571 i



përfshirë në ushtrinë e princit austriak merr pjesë në disa fushata ushtarake. Në betejën e Lepantos kundër turqve ai humbet dorën e tij të majtë. Pasi lirohet në 1575 duke u kthyer në shtëpi kapet rob nga një grup piratësh dhe lerohet vetëm pas pesë vitesh. Pasi kthehet në shtëpi ai bën punë nga më të rëndomtat. Kryevepra e tij ishte libri “Don Kishoti i Mançës”, i cili do të vlerësohej si një ndër kryeveprat e asaj kohe. Ky libër pasohet edhe nga vëllimi i dytë. Të librat janë shumë të vlerësuar nga kritikantët.

**1.2§ Titulli:** “Don Kishoti i Mançës” është një titull emëror e tregues.

**1.3§ Tema:** Një aristokrat vendos të kthejë kohën mbrapa duke u bërë një kalorës i arratisur.

**1.4§ Gjinia:** Roman i modelit tradicional që i përket periudhës së Rilindjes.

**1.5§ Përmbajtja:** ● Don Kishoti vendos të fillojë aventurat e tij.

- Arratisja e parë e tij.
- Mbërritja në han.
- Largimi nga hani.
- Takimi me Andrean dhe padronin e tij.
- Kthimi në shtëpi i heroit tonë.
- Gjyqi librave.
- Punësimimi i Sanço Panças.
- Arratisja e dytë e Don Kishotit.
- Lufta me mullinjtë e erës.
- Lufta me karamanin e Viskanjës.
- Takimi me barinjët.

- Historitë e barinjve.
- Takimi i Don Kishotit me hergjelexhinjtë e pashpit.
- Mbërritja në han.
- Ndodhitë që ngjanë në han
- Përrala e Sanço Panças.
- Helmata e Mambrinit.
- Takimi me të burgosurit dhe lirimi i tyre.
- Lufra me barinjët e beteja e deleve.
- Don Kishoti shkon në Sierra Morena.
- Peripecitë që kalon ai aty.
- Piani i priftit dhe i berberit.
- Historia e Lucindës e Kardenit.
- Vajtja në han.
- Novela e Provonjësit të krisur.
- Beteja me shakujt e verës.
- Ballafaqimi në han.
- Historia e princesësh Mimomikona.
- Historia e Jesirit.
- Historia e djaloshit qiraxhi.
- Shpëtimi nga arrestimi i Don Kishotit.
- Don Kishoti i maqgjepsur.
- Takimi me bariun e deleve.

**2.1 § Koha:**Libri u shkruajt në periudhën e Rilindjes në shek e pesëmbëdhjetë, në të njëjtën periudhë kur Shekspiri(*William Shakespare*) shkruajti “Romeo dhe Zhulieta” .

**2.2 § Hapsira:**Ngjarjet e këtij libri ndodhin në Spanjë,ne i shikojmë shpesh personazhet herë në pyje e zona të humbura e herë në hane e shtëpinë e Don Kishotit.

**2.3§ Fabula:**Një aristokrat vendos të bëhet kalorës ashtu sic kanë bërë stërgjyshërit e tij dhe të luftojë për drejtësinë dhe për për fitimin e zemrës së damës së tij. Ai ndihmohe nga kali i tij Rosinanti dhe Sanço Pança, një fshatar i thjeshtë, i cili e ndihmon të zotin e tij për gjatë shumë aventurave.

**2.4§ Personazhet:Don Kishoti** është personazhi në bazë të cilit është shkruajtur romani.Ai ka rol kryesor e funksion protagonist.Pasi kishte lexuar shumë libra dhe ishte magjepsur prej tyre ai kishte kaluar ne një stad ku nuk arrinte të logjikonte dhe vendos të fillojë një kapitull të ri në jetën e tij duke u shpallur kalorës i arratisur.Ai kalon shumë aventura bashkë me shqytarin e tij, i cili i vjen prapa hap pas hapi.E vecanta e tij ishte se sa herë që gjendej në situatë të vështira ai gjente forcën të vazhdonte duke fajësuar dikë tjetër apo duke gjetur justifikime.Ai luftonte për nder dhe për fama, por gjithashtu për fitimin e zemrës së damës së tij,Dylqinjës së Tobozës.

**Sanço Pança** ishte ndihmësi i Don Kishotit.Ai ka funksion ndihmës sepse detyra tij ishte të zbatonte atë çfarë i thoshte i zoti,por edhe t'i tregonte atij realitetin kur ai humbiste arsyen.Unë mendoj se se Sanço Pança ka rol kryesor sepse bashkë me të zotin e tij plotësojnë njëri-tjetrin dhe unë e mendoj të pamundur romanin pa figurën e tij.A i kishte rënë pre e premtimeve të zotit të cilat nuk u plotësuan kurrë.

**Dylqinja e Tobozës** ishte dama e zemrës së Don Kishoti.Është personazh me rol figurant e funksion ndihmës sepse në asnjë moment të librit nuk shfaqet duke vepruar,por ne e njohim nëpërmjet fjalëve të Don Kishotit.Dylqinja e Tobozës sic e quante heroi ynë ishte një katundare që në realitet quhej Akfonza Lorenzo dhe ai kishte rënë në dashuri me të kohë më parë, por nuk i kishte folur kurrë.Dashuria e Don Kishotit nuk ishte e vërtetë sepse në fakt ai nuk dashuronte Dylqinjën,por imazhin që kishte krijuar ai për të në mendjen e tij.

**Rosinanti** ishte kali i Don Kishotit, i cili ka rol dytësor e funksion ndihmës.Ishte një kalë i dobët e i pafuqishëm që shpesh herë rrëzohej bashkë me të zotin,por që në mendjen e të zotit ai ishte kali më i shpejtë e më i fuqishëm nga të gjithë kuejt e kalorësve të tjerë.

**Prifti** ishte mik i Don Kishotit, i cili mundohet shumë për ta ndihmuar.Ai ka rol dytësor dhe është personazh ndihmës e ndonjëherë antagonist kur kundërshton veprimet e Don Kishotit. Prifti ishte person i kulturuar dhe i mençur, i cili bashkë me **berberin** përpiqen ta kthejnë Don Kishotin në shtëpi e ta shërojnë.Berberi ka rol dytësor dhe funksion ndihmës.

**2.5§ Rrëfyesi:**Autori e është rrëfyes i jashtëm(veta e 3).

**2.6§ Konteksti:**Kjo vepër i përket periudhës së Rilindjes dhe është shkruajtur në Spanjë nga Miguel De Cervantes Savedra.

**2.7§ Paragrafët:**Në këtë tekst gjejmë paragrafë rrëfyes: “Ai po flinte akoma,kur prifti mori nga mbesa celësin e odës ku ndodheshin librat e dënuar, të cilin ajo ia dha me gëzim të madh dhe që të gjithë hynë Brenda bashkë me kujdestaren. Në odë ishin më tepër se njëqind libra të mëdhenj të lidhur mirë, dhe vec këtyre shumë të tjerë më të vegjël”<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Cervantes, Miguel: “Don Kishoti”, faqja 42.

Gjendet edhe paragrafi përshkrues: “Barinj të e dhive nuk e merrnin vesh atë lisan prej shqytarësh dhe kalorësish të arratisur,dhe s`bënin tjetër gjë vecse të hanin e të heshtnin e t`i shikonin mysafirët e tyre,të cilët me hir e me ëndje të madhe po gëlltisnin copa të mëdha sa grushti.”<sup>4</sup>

Paragrafi medietues: “-Po Don Kishoti, i cili e ndiente veten të shëndoshë e të fortë,sikundër thamë,donte të shkonte menjëherë për të kërkuar aventura,se në cdo rast që vononte i dukej si një humbje për botën dhe për të njerët,të cilët kishin nevojë për ndihmën dhe përkrahjen e tij,dhe,veçanërisht tani që kishte gatuar balsamin dhe mundte t`i përvishej punës me siguri më të madhe...”<sup>5</sup>

Paragrafi dialogues: “-Për zotin,-tha Sançoja,-i besoj të gjitha sa më thua,po rri pakëz drejt,se më duket sikur qëndron shtrembër,ndofta nga shkak që je vrarë nga të rrëzuanit.”<sup>6</sup>

“-Ashtu është vërtet,-u përgjigj Don Kishoti,-po s`ankohem për të dhemburat,se kalorësit e arratisur s`bën të qahen për asnjë plagë ,edhe sikur t`u dalin zorret jashtë.”<sup>7</sup>

**2.8§ Mjetet stilistikore:Komizmi** i përsëritjes e i imitimit(mënyra sesi flet e sillet Don Kishoti,përdorimi i mjeteve e ligjeve të vjetra në një botë të re)

**Manierizmi:**sjellja e personazheve.(Në shumë moment ku Don Kishoti apo Sanço Pança rrëzoheshin ishin moment komike)

**Anakronizmi** përdorimi i fjalëve që iu kaluar koha(p.sh Don Kishoti në vend të fjalës “aventura” përdorte fjalën “aventyra”)

Autori përdor shumë edhe **ironinë** kur flet për personazhet për t`i dhënë efekt më komik librit.

## 2.9§ Bërthamat rrëfyese(Bazë):

- Don Kishoti,jeta dhe ëndrrat e tij.
- Aventurat e para të tij.
- Aventurave të tij iu bashkohet Sanço Pança.
- Peripecitë e shumta që ata kalojnë.
- Kthimi i Don Kishotit në shtëpi dhe arratisja e tij.
- Aventurat që ai dhe Sanço Pança kalojnë bashkë.
- Rikthimi i Don Kishotit në shtëpi me ndihmën e priftit dhe berberit.
- Don Kishoti heq dorë nga kalorësia.

<sup>4</sup> Cervantes, Miguel: “Don Kishoti”, faqja 74.

<sup>5</sup> Cervantes, Miguel: “Don Kishoti”, faqja 116.

<sup>6</sup> Cervantes, Miguel: “Don Kishoti”, faqja 56.

<sup>7</sup> Cervantes, Miguel: “Don Kishoti”, faqja 56.

**3.0§ Interpretimet dhe kuptimet:** Ky roman si qëllim ka talljen e romaneve kabriake dhe talljen e sistemit feudal të kohës. Shumë shpesh personazhet gjenden në situata shumë komike e interesante. Ky libër lexohet në dy plane: horizontal e vertikal. Në atë horizontal (i sipërfaqes) jepen veprimet e personazheve dhe Don Kishoti shfaqet si figurë komike si shkak i ë folurit e përdorimit me mjete të vjetra në një botë të re. Në planin vertikal (i brëndisë) jepen interpretimet e veprimeve të personazheve dhe Don Kishoti shfaqet si një figurë tragjike për shkak të idealeve të larta që ka, heroizmit të tij e humanizmit të tij.

**¶Pjesa origjinale:** Pjesa ime preferuar është momenti i luftës me delet kur Don Kishoti shikon dy re të mëdha pluhuri dhe fillon t'i përshkruajë Sanços një betejë në mënyrë aq të bukur sa edhe vetë Sanço e beson e madje i fut frikën. Është e habitshme mënyra sesi Don Kishoti shikonte ëndrra me sy hapur dhe i tregon në mënyrë shumë të detajuar sikur po ndodhnin në realitet. Ai thotë : “Duhet të favorizojmë dhe të përkrahim të nevojtarët e të pafuqishmit. Dhe, duhet të dish, or Sanço, se atë që që vjen nga ana jonë e kryeson dhe e prin i madhi perandor Alifanfaron, zot i ishullit të madh Trapobana, ajo tjetra, që marshon prapa krahëve të mi, është e armikut të tij, mbretit të Garamantëve, Pentapolinit. Kthëpërveshur, se hyn gjithnjë në betejë me llërin të zhveshur.” Don Kishoti ishte shumë i entuzazmuar për atë betejë që do të ndodhte dhe vendoset në mes tyre se më në fund i kishte ardhur rasti t'i shfaqte aftësitë e tij. Ndërsa Sanço Panço largohet dhe kur e shikon se në realitet ishin vetëm disa dele përpiket ta bëjë të arsyetojë Don Kishotin, por ai e kishte humbur arsyen. Kur barinjët e deleve e panë Atë se po sulmonte delet e tyre ata e gjuajtën me gurë dhe ai ra nga kalë e u vra .

✓ *“Donkishotët e ditëve të sotme”*

Gjatë jetës njeriu ndërvepron me shumë individët të tjerë dhe shkëmben eksperiencë, mendime, emocione etj. Të gjithë janë të ndryshëm dhe kurrë të njëjtë. Nga njerëzit që unë takoj çdo ditë, ka persona të cilët më ngjajnë me “Don Kishotët të ditëve të sotme”. Më duken kështu sepse këta persona nuk ecin në një hap me kohën. Persona të cilët janë ende “me të vjetrën” ose siç i quajme ne ndonjëherë: “të dalë mode”. Për shembull kta persona mund të jenë prindërit tanë për të cilët shprehemi shpesh se nuk na kuptojnë, por ashtu siç e ndihmuan prifti dhe berberi Don Kishotin ashtu duhet edhe ne në një farë mënyre t'i ndihmojmë të na kuptojnë neve. Duhet bërë kjo sepse ata kanë jetuar në një kohë komplet tjetër dhe jeta e tyre nuk ka qenë aspak e ngjashme me kohën ku jetojmë ne. Ashtu siç Don Kishoti për ne u bë personazh i pëlqyeshëm pasi lexuam librin, e njëjta do të ndodhë po ndalemi për pak dhe të shikojmë problemin me vëmendje. Do t'i gjenim zgjidhje këtij problem dhe dalëngadalë do t'i kuptojmë edhe gabimet tona. Është e vërtetë se ne e mendojmë botën tonë shumë të ndryshme nga ajo e prindërve tanë, por në fakt nuk është. Sepse një ditë edhe ne do të zëmë vendin e tyre dhe fëmijët tanë do të na shikojnë në të njëjtën mënyrë. Pra duke qënë se të dyja palët jetojnë në “botë të ndryshme” dhe shikojnë vetëm atë që duan, siç bënte Don Kishoti, atëherë kush janë “Don Kishotët e vërtetë”? Unë menj se secili prej nesh ka ngjashmëri me Don Kishotin në pikpamjen e karakterit dhe të gjithë kemi nevojë për njëri-tjetrin në momentet e vështira.

**▣Përfundimi:**Leximi i këtij libri më ka lënë mbresa të bukura sepse më pëlqyen dhe personazhet dhe ndërthurja e ngjarjes.Në fund të librit edhe vetë Don Kishoti i kupton marrëzitë e veta dhe heq dorë prej, ai e kupton se gjatë gjithë kohës syri i tij kishte parë atë çfarë donte mendja e tij dhe se kishte humbur arsyetim duke jetuar në një botë imagjinare të krijuar prej tij si shkak i mospëlqimit të realitet ku jetonte.Arsyeja pse Don Kishoti vendosi në fillim të ndërmerre ato aventura ishte sepse i magjepsur nga historitë e kalorësve tina ai donte të ishte një prej tyre. Si rrjedhim ai vendosi ta krijonte vetë historinë e tij duke shpresuar se një ditë a do të njihej nga të gjitha për aventurat e tij.Sipas mendimit tim ky libër jep mesazhin se të gjithë jemi heronjtë e vetë historive tona.Me këtë unë kuptoj se cilido prej nesh ka potencial,aftësi e talente të cilat duhet të pasqyrohen në jetën tonë të përditshme,ne nuk duhet të jetojmë me frikë. *“Po jetojmë me frikë,nuk kemi jetuar fare”*